

# DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



## HAPËSIRA MË E RE VIRTUALE/ BRANDI QË NA BASHKON - RRENJETEMIA.AL !

“Dhoma e Biznesit te Diasporës” me mbështetjen e “Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë”, ju njeh me hapësirën më të re virtuale [www.rrenjetemia.al](http://www.rrenjetemia.al) dedikuar promovimit të krijimtarisë tradicionale shqiptare. Artizanët, të apasionuarit pas krijimtarisë artizanale, sipërmarrësit, tregtuesit dhe koleksionistët e veprave artizanale në vend dhe në diasporë, duke krijuar profilin e tyre në këtë mjedis bashkëkohor prezantimi, bëhen pjesë e panairit virtual në shërbim të promovimit të krijimtarisë së tyre tradicionale.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## BONOT PËR DIASPORËN', KUSH MUND TË INVESTOJË DHE SA ËSHTË FITIMI NGA INVESTIMI NË KËTO LETRA ME VLERË

Lajmi se do të emëtohen letra me vlerë “Bono për Diasporën” dedikuar bashkëatdhetarëve, u bë me 6 korrik 2021, ndërsa me datë 15 korrik 2021, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve njoftoi se ka bërë të gjitha përgatitjet për emëtimin e Bonove të Diasporës, ku edhe tregoi se periudha për investim do të filloj me datë 21 korrik 2021 dhe do të përfundoj me 18 gusht 2021. MFPT ka publikuar një broshurë ku ka dhënë shpjegime më të detajshme se çka janë këto letra me vlerë, kush mund të investoj, sa janë përfitimet e sa janë të sigurtat. Bonot për Diasporën janë Bono për shitje me pakicë, lloj i letrave me vlerë të borxhit, të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, dhe të dedikuara për diasporën.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## FISKALIZIMI, TATIMET SHTYJNË VLEFSHMËRINË E DOKUMENTEVE EKZISTUESE DERI MË 31 GUSHT

Nga 1 korriku nisi faza e dytë e fiskalizimit për transaksionet pa para në dorë mes subjekteve, në të cilën përfshihen 34 mijë subjekte. Por, ashtu siç kanë deklaruar shpesh shumica e ndërmarrjeve, sidomos biznesi i vogël, nuk janë plotësisht të gatshëm për të implementuar këtë sistem të ri, pasi krijon konfuzion te subjektet për mënyrën e faturimit. Kështu përveç faktit se pjesën e dytë të këtij viti, Tatimet e kanë cilësuar si një periudhë tranzitore që nuk do të lejohen gjordat, ditën e djeshme ka bërë me dije një tjetër vendim, i cili lehtëson disi bizneset. Konkretisht, Administrata Tatimore ka vendosur që dokumentacioni tatimor që përdorin aktualisht bizneset do jetë i vlershëm deri në fund të gushtit. Ndërsa bëhet me dije se, bizneset kanë afat të tërheqin këtë dokumentacion deri në 15 gusht.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## JAVA NË LAJME

DREJTORESHA E QBD TAKIM ME DREJTUESEN E BIBLIOTEKËS QENDRORE SHQIPE NË KROACI



NISIN FLUTURIMET DREJT ZYRIHUT DHE STAMBOLLIT NGA “FLATRAT E VERIUT”



KOSOVË/MINISTRJA GËRVALLA NË KQZ, INFORMOHET PËR PROCESIN E VOTIMIT TË DIASPORËS



## KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	104.6	105.2
EUR	122.9	123.5
CHF	110.8	111.6
GBP	143.4	144.4
DKK	16 <sup>.22</sup>	16.62